



DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E PARANDALIMIT TË  
PASTRIMIT TË PARAVE

# RAPORTI VJETOR 2020



# RAPORTI VJETOR 2020



Republika e Shqipërisë  
Ministria e Financave dhe Ekonomisë Bulevardi  
"Dëshmorët e Kombit", nr. 3 Tiranë.  
Tel: +355 42 24 4 602  
[www.fiu.gov.al](http://www.fiu.gov.al)

# PËRMBAJTJA

SHKURTIMET	4
MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	5
MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDRAT E BLOKIMIT TË PËRKOHSHËM	6
Raportet e aktivitetit të dyshimtë	7
Analizimi dhe referimi në organet e zbatimit të ligjit	9
Urdhrat e bllokimit të përkohshëm	12
TIPOLOGJI TË RASTEVE TË REFERUARA NË ORGANET LIGJZBATUESE	13
Tipologji 1: Kryerja e një aktiviteti fiktiv	13
Tipologji 2: Investimi në pasuri të paluajtshme nga organizatë kriminale	15
Tipologji 3: Dyshime për korrupsion dhe ushtrim të ndikimit të paligjshëm	16
Tipologji 4: Dyshime për skemë të pastrimit të parave nga një PEP	17
Tipologji 5: Transferta të dyshimta gjatë periudhës Covid-19	18
ANALIZA STRATEGJIKE	19
NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE DHE ANALIZA E PËRPUTSHMËRISË	20
Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese	20
Analizimi i përputshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë	22
MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESET GJYQËSORE	24
Masat administrative	24
Ekzekutimi i masave administrative dhe proceset gjyqësore	26
BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR	27
Bashkëpunimi kombëtar ndër-institucional	27
Shkëmbimi i informacioneve me NjIF	29
Procesi i vlerësimit nga komiteti Moneyval i KiE	29
Procesi i vlerësimit nga ICRG	30
Ndryshime ligjore	31
BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TI	32
Buxheti dhe menaxhimi i tij	32
Menaxhimi i burimeve njerëzore	34
Teknologjia e informacionit	36
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021	37

## SHKURTIMET

<b>AMF</b>	- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
<b>ASHK</b>	- Agjencia Shtetërore e Kadastrës
<b>BE</b>	- Bashkimi Evropian
<b>BSH</b>	- Banka e Shqipërisë
<b>BMP</b>	- Bordi i Mbikëqyrjes Publike
<b>DPD</b>	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
<b>DPPPP</b>	- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
<b>DPPSH</b>	- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
<b>DPT</b>	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>DSIK</b>	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
<b>Egmont</b>	- Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë
<b>FATF</b>	- Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar
<b>KiE</b>	- Këshilli i Evropës
<b>Moneyval</b>	- Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
<b>NjIF</b>	- Njësi e Inteligjencës Financiare
<b>PP/FT</b>	- Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit
<b>PP</b>	- Prokuroria e Përgjithshme
<b>OJF</b>	- Organizatë Jo-Fitimprurëse
<b>QKB</b>	- Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>RAD</b>	- Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë
<b>SHKK</b>	- Shoqëri Kursim Krediti
<b>SHISH</b>	- Shërbimi Informativ i Shtetit
<b>SPAK</b>	- Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
<b>ZKV</b>	- Zyrë Këmbimi Valutor
<b>TI</b>	- Teknologjia e Informacionit

# MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Në përmbushje të detyrimit ligjor për informimin publik dhe në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, kam nderin dhe kënaqësinë t'ju paraqes raportin vjetor të institucionit për vitin 2020. Në këtë raport, janë pasqyruar aspektet kryesore të veprimtarisë institucionale, progresi i arritur i shoqëruar me rezultatet konkrete në përmbushjen e misionit, detyrave funksionale dhe objektivave konkret.

Veprimtaria e DPPP ka gjatë këtij viti ka qenë e orientuar në një sërë drejtimesh, të cilat përveç përmbushjes së funksionit parësor të institucionit si Njësi e Inteligjencës Financiare në Shqipëri, ka përfshirë dhe realizimin sa më efektiv të rolit mbikëqyrës të subjekteve të ligjit, mbështetjen e vazhdueshme të subjekteve nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit në funksion të zbatimit të legjislacionit PPP/FT, në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit Shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të BE-së, koordinimin e punës me institucionet Shqiptare dhe raportimin në Komitetin MONEYVAL të KiE dhe FATF, në kuadër të procesit të vlerësimit të vendit.


Gjatë këtij viti DPPP ka realizuar dhe një sërë aktiviteteve nëpërmjet të cilave është synuar të finalizohen vlerësimet sektoriale apo strategjike në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike në drejtim të përmbushjes sa me efektive të detyrimeve institucionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, informimin e publikut në lidhje

me zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira, bashkëpunimin e ngushtë me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, zbatimin e dokumenteve strategjike në kuadrin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Pjesë e rëndësishme e aktivitetit vjetor të DPPP ka qenë gjithashtu bashkëpunimi i ngushtë me strukturat e vlerësimit kalimtar të Gjyqtarëve, Prokurorëve dhe të zyrtarëve të lartë të Policisë si dhe kontributi aktiv në drejtim të hetimit nga "Operacioni Forca e Ligjit" të veprave penale dhe të ardhurave të jashtëligjshme të siguruar nga aktivitetet kriminale brenda dhe jashtë vendit.

Rezultatet dhe përvoja e përfutur gjatë këtij viti, do të shërbejnë padyshim si një bazë e sigurt për të vijuar pa reshtur punën e DPPP, për të vënë në dispozicion të organeve kompetente burimet analitike dhe ekspertizën e vyer në funksion të identifikimit dhe gjurmimit të fondeve të jashtëligjshme dhe personave të përfshirë në aktivitete kriminale, më qëllim mbrojtjen e integritetit të sistemit financiar, ekonomisë kombëtare dhe sigurisë së vendit

Në përfundim, dua të vlerësoj maksimalisht përpjekjet, përkushtimin dhe punën e të gjithë kolegëve të DPPP, të cilët në sajë të angazhimit të tyre shpeshherë në kushtet e pazakonta, vështirësive dhe kufizimeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19, kanë bërë të mundur arritjen e rezultateve të prezantuara në këtë raport.



# MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDHRAT E BLOKIMIT TË PËRKOHSHËM

Një nga funksionet themelore të DPPPP, i përcaktuar në ligj, është mbledhja e raporteve të aktivitetit të dyshimtë (RAD) analizimi i tyre, marrja e informacioneve shtesë nëse nevojiten, duke konkluduar në referime apo dërgime informacioni në organet e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës. Vitet e fundit, në vëmendje ka qenë edhe shpërndarja e një sërë rastesh për DPT me qëllim vlerësimin nga pikëpamja fiskale kur ka pasur dyshime për evazion fiskal apo fshehje të ardhurash.

Me rëndësi në sistemin parandalues mbeten RAD nga një sërë subjektsh raportuese dhe institucionesh shtetërore, në përputhje me ligjin, standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira. Burime të tjera përbëjnë kërkesat për bashkëpunim nga Njësitë Inteligjente Financiare Partnere, kërkesat nga institucionet brenda vendit, si dhe analizat e ndryshme sektoriale.

Gjatë analizimit të informacioneve të siguruara nga këto subjekte apo institucione, përcaktohen prioritetet e rasteve, bëhet analizimi i të dhënave që disponohen dhe në rast se konstatohen dyshime,

dërgohen më tej për ndjekje të mëtejshme në institucionet ligj zbatuese apo të inteligjencës, si dhe nëse është e nevojshme merren edhe masa për bllokim të përkohshëm të transaksioneve.

Duke marrë në konsideratë analizën e përgjithshme të dhënave statistikore të paraqitura në vijim, konstatohet:

- rritje të numrit të RAD të dërguara nga subjektet banka, që janë subjektet raportuese që zënë peshën kryesore në parandalimin e PP/FT;
- thellimi i mëtejshëm në informacionin e dërguar në organet ligj zbatuese me të dhëna të plota dhe të argumentuara financiare, për të rritur më tepër efektivitetin e ndjekjes së mëtejshme të rasteve në organet kompetente;
- rritje të raportit midis fondeve të bllokuara nga DPPPP me ato të sekuestruara nga Prokuroria apo Gjykata;

## Raportet e aktivitetit të dyshimtë

Për Njësitë e Inteligjencës Financiare, siç është DPPP, RAD e raportuara nga subjektet e ligjit kanë rëndësi thelbësore, pasi mbi bazën e tyre vijohet me analizat, referimet në agjencitë e zbatimit të ligjit, identifikimin e tipologjive PP/FT dhe kategorizimin e transaksioneve të përfshira.

Gjatë vitit 2020, në DPPP janë dërguar 1,409 RAD nga subjektet raportues, të cilat paraqiten të kategorizuara në tabelën 1, të krahasuara me periudhat pararendëse.

Tabela 1: RAD të raportuara, sipas kategorisë së subjekteve për periudhën 2016-2020.

Subjekti raportues	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Banka	619	686	563	651	703
Shoqëri transfertash	209	165	247	319	316
DPD	47	46	49	43	44
DPT	3	5	10	12	10
ZQRPP/ASHK	134	83	164	33	0
Noter	205	254	469	335	321
ZKV	14	20	7	6	4
Shoqëri auditimi	1	0	0	0	0
Inst. financiare të mikro-kredisë	2	10	2	0	9
Shoqëri të qiradhënies financiare	15	5	2	0	0
Shoqëri ndërtimi	0	5	0	5	2
Shoqëri tregtimi mjeteve motorike	35	101	6	10	0
Shoqëri pagesash elektronike	6	2	6	0	0
Tjetër	2	2	0	10	0
<b>Total</b>	<b>1,292</b>	<b>1,384</b>	<b>1,525</b>	<b>1,424</b>	<b>1,409</b>


Bazuar në të dhënat e tabelës rezultojnë se vazhdojnë të mbizotërojnë raportimet e sistemit bankar, të cilat për vitin 2020 përbëjnë 50% të numrit total RAD, e ndjekur nga raportimet nga subjekte noter me 23 % dhe institucionet financiare për transferimin e parasë me 22%.

Këtë vit vihet re se kemi të njëjtën tendencë për sa i përket numrit total të RAD të raportuara edhe kategorive raportuese, përveç një mungese të raportimeve nga ASHK.

DPPPP në kuadër të rritjes së numrit të raportimeve nga subjektet e ndryshme, përmirësimin e cilësisë së tyre edhe pse në një situatë të vështirë për shkak të pandemisë, ka ndër marrë këto veprimtari:

- informimi i subjekteve në lidhje me tendencat dhe tipologjitë e PP/FT;
- mbikëqyrja e subjekteve bazuar në kategorizimin e riskut;
- masa administrative të vendosura në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore të subjekteve;
- bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit;
- trajnime të realizuara dhe rritje e ndërgjegjësimit të subjekteve raportuese

Grafiku 1: Ecuria e raportimeve të RAD për periudhën 2016-2020.




Nga RAD e dërguara përgjithësisht vazhdojnë të mbizotërojnë tipologjitë që lidhen me: blerje të pasurive të paluajtshme apo të luajtshme me burim të panjohur të fondeve, transfertat e dyshimta apo me anomali të dukshme, veprime nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale, hua/marrje hua për/nga të tretë, sponsorizime/dhurime / nga / për të tretë, ndërmjetësim të dyshimtë në transaksione nga disa profesione të rregulluara me ligj, ndërveprime financiare të pa mbështetura me dokumentacion mes personash juridik.

Pandemia COVID-19 është shoqëruar edhe

me mënyra të ndryshme reagimi si nga sektori publik apo edhe privat, të cilat përfshijnë ndihma sociale, shit-blerje të produkteve mjekësorë të caktuara, që kanë ndikuar si në sjelljen financiare të institucioneve financiare por edhe klientëve të tyre. Kjo situatë mund të ofrojë mundësi të reja për personat e përfshirë në veprimtari kriminale për të siguruar të ardhura të jashtëligjshme apo mundësuar procesin e pastrimit të parave. Bazuar në analizimin e RAD të dërguara gjatë vitit 2020 në DPPPP, rezultojnë se janë raportuar raste edhe pse sporadike që lidhen me transaksione të dyshimta apo edhe mashtrim për shit-blerje produkteve mjekësore apo përfitim të paligjshëm të ndihmave.



## Analizimi dhe referimi në organet e zbatimit të ligjit, ato të inteligjencës dhe fiskale



Analiza e informacionit është një proces kompleks i mbështetur në një sërë elementësh si të indikatorëve të detektuar, analizë të informacionit të rezultuar dhe siguruar, kryqëzim të dhënash, për të zbuluar raste të dyshimta në funksion të parandalimit të PP/FT, me qëllim dërgimin për investigim në agjencitë e zbatimit të ligjit, organet e inteligjencës apo NJIF partnere, veprimtari kjo që synon funksionimin e një sistemi efektiv parandalues. Baza e të dhënave e përditësuar në vazhdimësi, si dhe shembujt më të mirë nga praktikat ndërkombëtare ndihmojnë këtë proces të evoluojë duke iu përshtatur vazhdimisht dinamikës së realitetit.

Një nga funksionet më të rëndësishme të DPPPP, është mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e rasteve të dyshimta për organet e zbatimit të ligjit dhe ato të inteligjencës konkretisht me Prokuroritë

e juridiksionit të përgjithshëm, SPAK, DPPSH dhe SHISH.

Gjatë vitit 2020 iu kushtua rëndësi procesit të analizës:

- Për sa i përket prioritarizimit të raportimeve, duke kushtuar rëndësinë e duhur rasteve të plota me elementë të dyshimtë dhe tregues të tjerë që çojnë në një dërgim rastesh më cilësore dhe të bazuara tek organet ligj zbatuese;
- Vlerësimin të shpejtë për të bërë të mundur bllokimin në kohë të fondeve, për të cilat kishte dyshime të bazuara se vinin nga një aktivitet i paligjshëm, në bashkëpunim të ngushtë me organet ligj zbatuese.

Rastet e referuara në organet ligj zbatuese gjatë këtij viti paraqiten në tabelën 2.

Tabela 2: Rastet e referuara për periudhën 2016 – 2020.

Referimet	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Referimet në Prokurori	120	131	33	25	41
Referimet në Polici	291	270	343	241	227
Total	411	401	376	266	268

Krahas dërgimit të rasteve në Prokurori dhe Polici gjatë vitit 2020 ka patur edhe 43 raste të dërguara në DPT të konkluduara me dyshime për evazion fiskal/fshehje të ardhurash apo shkelje të tjera të legjislacionit tatimor.

Në këtë kontekst gjatë vitit 2020 DPPPP ka dërguar 83 informacione në SHISH në lidhje me çështjet të dyshuara për aktivitet kriminal.

Përveç dërgimit të rasteve të reja, me rëndësi mbeten edhe informacionet vijuese apo të dhënat e reja të lidhura me çështje të dërguara më herët, të cilat konfirmojnë dhe thellojnë dyshimet e konstatuara për këto raste.

Vlen të përmendet se pesha më e madhe të rasteve të dërguara nga DPPPP i janë adresuar DPPSH, si organi ligj zbatues kryesor në vend dhe i specializuar për kryerjen e veprimeve hetimore.

Tabela 3: Informacionet e referuara në DPPSH 2019-2020 dhe ecuria e tyre.

Referimet	Viti 2019	Viti 2020
Referimet në DPPSH nga DPPPP	241	227
Kallëzime nga DPPSH me indicie nga DPPPP	190	110

Ndër rastet e dërguara nga DPPP për 2020, 110 prej tyre kanë shërbyer si indicie për referimet e bëra nga DPPSH për nenin 287 të Kodit penal.

Gjatë vitit është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm me DPPSH, në lidhje me rastet e referuara dhe ecurinë e tyre. Kjo iniciativë ka ndikuar në përmirësimin e rritjen e efektivitetit për trajtimin e shkresave të referuara nga DPPP.

Ndër rastet e dërguara në Prokurori, mbizotërojnë

ato të dërguara në Prokurorinë e Tiranës të cilat përbëjnë 58% totalit, ndërkohë që vërehet një shpërndarje e rasteve të tjera në Prokuroritë e rretheve Vlorë, Elbasan, Sarandë si dhe SPAK.

Për sa i përket indicies nga kanë filluar rastet e dërguara në agjencitë ligj zbatuese, rezulton se burim kryesor i tyre mbeten RAD nga subjektet e ligjit, të cilat kanë shërbyer si pikë nisje për 87 % të referimeve.

Tabela 4: Indiciet për rastet e dërguara gjatë vitit 2020 në DPPSH dhe Prokurori.

	RAD	Analiza sektoriale	NjIF Partnere	Njoftime/Burime të hapura	Total
Referimet në Prokurori	34	2	3	2	41
Referimet në Polici	202	12	5	8	227
Total	236	14	9	10	268

Fakti që dominojnë bindshëm rastet e referuara me indicie nga RAD, është tregues i drejtpërdrejtë i efektivitetit të sistemit parandalues.

DPPP i kushton rëndësi edhe identifikimit të mënyrës së veprimit dhe metodave të ndjekura për kryerjen e pastrimit të produkteve të veprës penale apo financimit të terrorizmit, dhe konkretisht gjatë vitit janë vërejtur kryesisht këto tregues të aktivitetit të dyshimtë:

- investime të larta në pasuri të paluajtshme me burim të panjohur fondesh;
- investime në mallra luksi nga persona të cilat nuk justifikojnë burimin e fondeve apo persona me precedentë penalë;
- transferta të dyshimta (në mbërritje apo në dalje edhe në tentativë) me përfshirje të subjekteve/shtetasve të huaj dhe të pajustificuara me dokumentacion mbështetës;
- sponsorizime/ dhurime/ dhënie huaje nga/ për të tretë pa u konstatuar lidhje të mundshme

mes palëve;

- transaksione të pazakonta krahasimisht me profilin financiar të personit/subjektit;
- mashtrime të formave të ndryshme;
- transaksione financiare të kryera nga persona me precedentë të mëparshëm penalë apo persona të lidhur me ata me precedentë;
- transferta të dyshimta me vende të konsideruara me risk;
- ndërmjetësime të dyshimta në transaksione nga profesionistë të lirë për përfitime të dyshuara pjesërisht si të paligjshme,
- transferta të mëdha vlerash (brenda dhe jashtë vendit) midis personave juridik të pa mbështetura me dokumentacion;

Gjatë analizës së informacionit i është kushtuar vëmendje edhe identifikimit të burimit të fondeve/pasurisë, veprimtarisë së paligjshme, si dhe lidhjeve të mundshme kriminale të personave/ subjekteve.

Tabela 5: Të dhëna për klasifikimin e veprës së origjinës për periudhën 2016 – 2020.

Veprat e origjinës	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Trafikim të lëndëve narkotike	30	43	31	28	35
Trafikim i qenieve njerëzore / shfrytëzim prostitucioni	7	2	2	5	4
Krijim/drejtim/ përfshirje në organizata kriminale	6	5	3	4	2
Financim terrorizmi	8	5	2	4	6
Mashtrim, mashtrim financiar, mashtrim kompjuterike	17	15	13	18	13
Falsifikim	2	5	2	4	2
Shpërdorim detyre / korrupsion kryesisht pasiv/ Dyshim për ushtrimi të ndikimit të paligjshëm	9	13	5	10	12
Mos deklarim shumave dhe sendeve me vlere në kufi	2	1	1	3	4
Vjedhje, grabitje, kanosje	3	7	6	5	5
Trafikim i mjeteve motorike/ shmangie detyrime doganore/ kontrabandë	4	0	0	3	3
Dyshime për evazion fiskal/(fshehje te ardhurash)	9	16	5	14	9
Precedentë të mëparshëm kriminalë	12	17	19	17	11
Ndihmë për kalim te paligjshëm të kufirit	-	-	-	-	4
Nuk dihet	302	272	287	151	158
<b>Total</b>	<b>411</b>	<b>401</b>	<b>376</b>	<b>266</b>	<b>268</b>

Tabela e mësipërme paraqet rastet e dërguar në organet ligj zbatuese Prokurori dhe DPPSH, për të cilat është arritur të identifikohet vepra e origjinës Edhe për vitin 2020 numrin më të lartë të veprimtarive kriminale, për të cilat është bërë i mundur identifikimi i lidhjes me veprën e origjinës e zë trafikimi i lëndëve narkotike, mashtrimi,

precedentët e mëparshëm kriminalë, shpërdorimi i detyrës, evazoni fiskal dhe fshehja e të ardhurash etj.

Në linjë me vitet e mëparshme, mbizotërojnë rastet për të cilat vepra penale e origjinës nuk ka qenë e mundur të përcaktohet. Për këto raste analiza financiare ka konkluduar se:

- **fondet e përdorura nuk kanë patur burime të ligjshme;**
- **veprimet financiare kanë patur anomali të dukshme;**
- **qëllimi ekonomiko-ligjor ka qenë bindshëm i dyshimtë;**
- **kanë pasur ngjashmëri të theksuara me tipologjitë e njohura ndërkombëtare,**

raste të cilat dërgohen për ndjekje të mëtejshme duke u bazuar në parimin “ndiq paranë” që është një nga më themelorët në punën e NJIF.

Duke marrë në konsideratë se eksponentët e krimit, për të cilët disponohen të dhëna për veprimtari kriminale, apo personat për të cilët nga burime të ndryshme rezultojnë të dhëna për shpërdorim

detyre/korrupsion, tanimë janë të familjarizuar për rreziqet ligjore që mund të kenë në rast kryerje transaksionesh në emër të tyre apo familjarëve, ka pritshmëri që një pjesë e rasteve për të cilat nuk rezulton vepër kriminale e lidhur në fazën e trajtimit të rasteve nga DPPSH, të jenë pikërisht të lidhura me dy grupimet e sipërcituar.

## Urdhërat e bllokimit të përkohshëm

Në rastet kur DPPPP ka arsye të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete për PP/FT, në funksion të parandalimit të tjetërsimit të produkteve financiare kriminale, urdhëron bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit financiar, për një periudhë jo më shumë se 72 orë dhe informon Prokurorinë por, tanimë prej vitesh, informohet njëkohësisht dhe DPPSH, në funksion të realizimit të veprimeve procedurale.

Gjatë vitit 2020, janë nxjerrë në total 7 urdhra bllokimi të përkohshëm për llogari bankare, në një vlerë totale prej rreth 1.1 milion EUR, të cilat janë sekuestruar me vendim të Prokurorisë apo Gjykatës në masën 100%.

Tabela 6: Urdhërat e bllokimit dhe sekuestrimet (në EUR) për periudhën 2016 – 2020.

Viti	Nr. i urdhrave të bllokimit nga DPPPP	Shuma totale e bllokuar (EUR)	Shuma totale e sekuestruar (EUR)	Raporti sekuestrime/ bllokime
2016	61	28,772,733	8,129,000	28%
2017	52	11,263,587	9,096,233	81%
2018	24	5,428,270	4,536,595	84%
2019	16	9,699,690	7,841,091 <sup>1</sup>	81%
2020	7	1,172,291	1,172,886	100%


Nga të dhënat e tabelës së mësipërme vihet re se pavarësisht rënies në numër të urdhrave të bllokimit në krahasim me vitet e mëparshme, konstatohet një rritje në lidhje me raportin e fondeve/pasurive të sekuestruara mbi ato të bllokuara, ku në vitin 2020 ky raport është 100% çka për DPPPP përbën një tregues të konsoliduar pozitiv për sa i përket efektivitetit të sistemit parandalues.

<sup>1</sup> Duke konsideruar dhe 940.000 EUR pasuri të paluajtshme të sekuestruara në bazë të referimit të dërguar nga DPPPP, vlera totale është 8.7 milion Eur.

# TIPOLOGJI TË RASTEVE TË REFERUARA NË ORGANET LIGJZBATUESE

## Tipologji 1: Kryerja e një aktiviteti fiktiv

Shtetasi i huaj X në më pak se 1 vit hap 4 kompani në Shqipëri që kanë aktivitet në fusha të që lidhen me ndërtimin, import-eksport mallrash të veshjeve, shitblerje pasurish të paluajtshme si dhe zhvillim të biznesit, për të cilat hap llogari të në banka të ndryshme.



Në llogaritë bankare të disa prej këtyre kompanive, u vunë re transfertat në vlera të konsiderueshme të dërguara nga vende të cilësuar me risk të lartë për pastrim parash, mes të cilave veçojmë:

- Kompania A për periudhën Janar - Mars 2020 ka përfituar 450,000 USD nga një kompani me vendndodhje në shtetin 1, pjesa më e madhe e të cilave (330,000 USD) tërhiqen në para fizike nga vetë shtetasi duke deklaruar se këto fonde do të përdoren për blerje kompjuterësh, makina të ndryshme dhe produkte mjekësore në Shqipëri dhe në një vend fqinj. Në mars 2020 'A' transferon 70,000 EUR në një vend të rajonit për blerje produktesh që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe një pjesë të fondeve të kredituara në llogarinë e subjektit janë përdorur për blerje me kartë (POS).
- Nga komunikimi me NJIF partnere është konstatuar se, A gjatë një periudhe dy vjeçare në llogaritë që disponon në shtetin 1, ka përfituar dhe dërguar transfertat bankare nga dhe për subjekte të ndryshme po në shtetin 1, në vlera të larta që arrijnë në një total prej 4,000,000 USD.
- Kompania B, për periudhën Janar – Maj 2020 ka përfituar 110,000 EUR të urdhëruara nga subjekte të ndryshme nga vendet: 2, 3, 4 dhe 5 me përshkrim: për shitblerje malli, maska, doreza. Më pas fondet e kredituara transferohen në favor të kompanive të ndryshme në SHBA dhe Kinë për pagesë faturash, një pjesë përdoren për blerje me kartë (POS) të produkteve të ndryshme por edhe të shërbimeve që lidhen me fushën e IT. Blerjet realizohen në vende të ndryshme të botës.

Kompania B ka deklaruar pranë subjekteve financiare se importon mallra nga një vend i rajonit dhe një vend i BE dhe më pas i eksporton në varësi të kërkesave. Nga verifikimet e DPPPP rezultoi se asnjë prej shoqërive të shtetasi X, nuk kishte kryer procedura doganore import/eksporti.

Gjithashtu për shtetasin X rezultuan të dhëna për mashtrim, për shkak se ky shtetas premtojte shitje të produkteve të ndryshme kundrejt pagesave bankare, por malli për të cilin ishte rënë dakord nuk ju lëvrohej klientëve.

Nga verifikime të mëtejshme rezultoi se:

- Kompanitë e shtetasi X, nuk kishin aktivitet tregtar në vendin tonë (pa punonjës dhe për më tepër pa aktivitet shit-blerje);
- Adresat e subjekteve nuk janë të sakta dhe bizneset nuk ekzistojnë;
- Shtetasi X, nuk kishte hyrje-dalje të regjistruara në vendin tonë;

Bazuar në dyshimet:

- Themelimi i shoqërive të ndryshme brenda një periudhe të shkurtër kohore nga një shtetas i huaj me një profil jo të qartë;
- Transfertat të larta në mbërritje të pasuara me tërheqje të fondeve apo blerje me kartë;
- Fonde të përfituara në formën e pagesave të faturave, ndërkohë që subjekti përfitues nuk ushtronte aktivitet financiar;
- Indiciet për mashtrim;

Informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

## Tipologji 2: Investimi në pasuri të paluajtshme nga organizatë kriminale


Shtetasi A, ishte i njohur për organet ligj zbatuese për përfshirjen në veprimtari kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike si dhe për lidhjet e tij me persona me precedentë kriminal rezultojnë të jetë larguar nga Republika e Shqipërisë duke jetuar prej vitesh jashtë vendit.

Nga të dhënat e DPPPP rezultoi se shtetasi A, kishte kryer investime të konsiderueshme në pasuri të paluajtshme. Ai kishte caktuar shtetasin B, të vepronte si përfaqësues me prokurë në Shqipëri, për shitjen e pasurive të tij të paluajtshme dhe më pas kalimin fondeve.

Ndër vite si blerës për pasuritë e zotëruara nga shtetasi A, shfaqeshin shtetas të ndryshëm, ndërkohë nga një analizë e thelluar për rastin u vu re se në vitin 2019, si blerës rezultojnë dy shtetas të huaj E dhe F, të cilët fillimisht u dukën si blerës rastësorë, pa një lidhje midis tyre, të cilët nuk mund të kishin dijeni efektive rreth profilit të palës shitëse.

Nga verifikimet e mëtejshme të kryera rezultoi se shtetasit E dhe F, menjëherë pas blerjes së pasurisë nga shtetasi A, i rishitën këto pasuri. Me të ardhurat e fituara, shlyenin detyrimet ndaj shitësit A. Vlera e katër prej pronave të shitura kalonte vlerën 3 milion EUR.

Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, shtetasit E dhe F rezultojnë me lëvizje të përbashkëta. Nga media publike, shtetasit e huaj shfaqeshin si biznesmen të njohur dhe me dyshime për lidhjet e tyre politike.



Bazuar në:

- Përfshirjen e shtetasve me precedentë kriminal;
- Investimin në pasuri të paluajtshme, i cili është i njohur për rrezikun e lartë që mbart si mjet për kryerjen e pastrimit të parave;
- Zinxhiri i transaksioneve në dukje për të fshehur origjinuesin e të ardhurave;


U krijuan dyshime të arsyeshme për krijimin e një skeme të pastrimit të parave dhe informacioni i është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

## Tipologji 3:

### Dyshime për korrupsion dhe ushtrim të ndikimit të paligjshëm

Gjatë vitit 2016 shtetasi X me profesion avokat ka përfaqësuar tre palë (A,B,C) në gjykatë me objekt kundërshtimin e dëmshpërblimit të shpronësimeve të përcaktuar me VKM.

totale të dëmshpërblimit në llogarinë e shtetasit X dhe ky i fundit një pjesë të fondeve e kishte tërhequr dhe pjesën tjetër e ka transferuar për një familjar të ngushtë, i cili i kishte përdorur për blerje



Gjatë procesit gjyqësor një nga institucionet e paditura "Alfa", (në favor të së cilit ishin bërë shpronësimet) ishte përfaqësuar nga shtetasi Y.

Në përfundim të proceseve gjyqësore u evidentua se vlera e dëmshpërblimeve të përcaktuara nga Gjykata shkante në 13-fishin e dëmshpërblimeve të përcaktuar nga VKM.

Secila nga palët A, B, C kishin çelur llogari pranë një banke të nivelit të dytë dhe në llogari ishin kredituar dëmshpërblimet e akorduar nga institucioni shtetëror (Alfa). U konstatua se menjëherë pas kreditimit të fondeve palët A,B,C kanë transferuar rreth 75,000,000 Lek të vlerës

pasurish të paluajtshme.

Nga verifikimet e mëtejshme shtetasi Y, i cili përfaqësonte në Gjykatë institucionin "Alfa" që akordoi fondet e dëmshpërblimit, kishte njohje me shtetasin X dhe rezultonte i punësuar pranë studios ligjore të këtij shtetasi pasi kishin përfunduar proceset gjyqësore.

Bazuar në dyshimet e mësipërme, të lidhjeve mes përfaqësuesve të palëve në këtë proces gjyqësor, tërheqjet e fondeve nga shtetasi X duke lënë hapësirë për dyshime të arsyeshme në lidhje me përfituesit real të fondeve të tërhequra, rasti u referua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.




## Tipologji 4:

### Dyshime për skemë të pastrimit të parave nga një PEP

Shtetasi A, bashkëshort i shtetases B, ish-PEP në pozicion të lartë drejtues në një institucion publik X, rezultonte të kishte nënshkruar disa kontrata noteriale huaje, në cilësinë e palës huamarrëse me qëllim jo të qartë për sa i përket marrjes dhe përdorimit. Si huadhënës, shfaqeshin shtetas të njohur për DPPPP, si të përfshirë në dyshime për pastrim parash.

Nisur nga sa më sipër u kryen verifikime të mëtejshme nga ku rezultoi se shtetasi A, kishte regjistruar një person juridik, që ushtronte veprimtari në fushën e ndërmjetësimit, e emërtuar "DX".

Shoqëria "DX" më tej lidh një kontratë huaje nëpërmjet së cilës do t'i huazonte vlerën prej 40,000 EUR një shoqërie tjetër "EX", e cila do të kryente një pagesë në favor të një institucioni publik për një leje të miratuar në favor të shoqërisë. Verifikime të mëtejshme treguan se leja e miratuar, lidhej drejtpërdrejtë me interesat pasurore të shtetasit A.



Më tej, shtetasi A, bleu shumicën e kuotave të shoqërisë "EX" (të cilës i kishte dhënë hua, nëpërmjet shoqërisë "DX"), në vlerë 1 milion EUR, duke përforcuar dyshimet për krijimin e një skeme me qëllim humbjen e gjurmëve lidhur me përfutjesit fundor të lejes, mënyrës së grumbullimit të fondeve dhe arsyt e huadhënies në favor të një subjekti, të cilit i mungonte eksperiencia e duhur në sipërmarrjen e iniciuar rishtazi.

Bazuar në:

- Krijimin e një veprimtarie ekonomike në një fushë që nuk përputhej me profilin e mëparshëm të individit;
- Investimi në një shoqëri të dytë, e cila më herët kishte përfituar nga një leje e dhënë nga një Ent Publik;
- Origjina e huazuar e fondeve nga subjekte me profil të dyshimtë dhe përdorimi për investimet e kryera në biznes;

- Lidhja familjare me një ish-PEP;

U krijua dyshimi se kishim të bënim me një skemë të pastrimit të parave dhe informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.


## Tipologji 5: Transferta të dyshimta gjatë periudhës Covid-19

Shtetasit A, B, C, të dyshuar më herët për përfshirje në veprimtari kriminale, themelojnë në Prill të vitit 2020, shoqërinë Y, e cila sipas objektit të veprimtarisë do të shiste teste për Covid-19. Nisur nga profili i shtetasve, u kryen verifikime të mëtejshme nga ku rezultoi se shoqëria Y nuk kishte kryer importe të produktit objekt shitje.

Kjo shoqëri rezultonte të blinte teste nga shoqëria Z më një çmim për 30 EUR për njësi dhe më tej i shiste për 90 EUR, në favor të shoqërisë V. Shoqëritë Z dhe V, rezultonin të kishin si pronar përfitues shtetasin E, i njohur nga DPPP për përfshirje në raste të mëparshme të dyshimta.

Bazuar në:

- Zinxhirin e transaksioneve pa një arsytim logjik dhe ekonomik dhe rritjen fiktive të çmimit të pajisjeve të blera dhe të rishitura te kompani të ndryshme me të njëjtin pronar përfitues;
- Shfrytëzimin e periudhës së Covid-19;
- Përfshirjen e personave me profil të dyshimtë; krijonin dyshimin se kishim të bënim me një skemë të pastrimit të parave. Informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.





## ANALIZA STRATEGJIKE

Një ndër funksionet e DPPPP është edhe kryerja analizave sektoriale me qëllim evidentimin e tendencave, tipologjive, kërcënimeve dhe riskut për pastrim parash dhe financim terrorizmi në vend për sektorë dhe produkte të caktuara. Në këtë kuadër gjatë vitit 2020 nga DPPPP është koordinuar veprimtaria me institucionet e tjera të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, mbikëqyrëset dhe subjektet e ligjit për realizimin e analizave të riskut, në vijim të analizimit të risqeve të evidentuara nga Vlerësimi Kombëtar i Riskut i konkluduar në vitin 2019 edhe në kuadër të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit të FATF, për daljen nga lista e vendeve në monitorim.

Konkretisht janë konkluduar analizat e riskut si më poshtë:

- Analizë risku për pastrim parash për produktet dhe shërbimet bankare;
- Analizë për keqpërdorimin apo përfshirjen në pastrim parash të personave juridik;

- Analizë risku për pastrim parash në sektorin e pasurive të paluajtshme;
- Analizë për keqpërdorimin apo përfshirjen në pastrim parash të profesioneve të lira (avokat, agjent i pasurive të paluajtshme, kontabilist i miratuar/auditues ligjor);
- Analizë risku për mjetet virtuale dhe ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale për PP/FT;

Të gjitha dokumentet e mësipërme i janë shpërndarë në rrugë zyrtare në variantin e plotë institucioneve, mbikëqyrëseve dhe subjekteve kryesore që janë konsultuar dhe kanë dhënë kontribut porgjithashtu në variant të përmbledhur janë vendosur në modulën e raportimit të DPPPP, në të cilën kanë qasje subjektet e ligjit.

Vlen të përmendet se për realizimin e tyre DPPPP ka pasur mbështetje nga projekti “Programi Global për luftën kundër flukseve të jashtëligjshme” të Shoqatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe Këshilli i Evropës, nëpërmjet sigurimit të ekspertëve ndërkombëtarë.

# NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE DHE ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË

## Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese

Trajnimi i subjekteve të ligjit është një ndër detyrat funksionale të DPPPP dhe në këtë kuadër, gjatë vitit 2020, janë organizuar një numër i konsiderueshëm trajnimesh (kryesisht në formë elektronike si pasojë e pandemisë) të kategorive të ndryshme të subjekteve të ligjit si: Banka, IFJB, Zyra Këmbimi Valutor dhe agjentë të transferimit të parave, SHKK, Shoqëri Sigurimesh, Fonde Pensioni, Noter, Avokat, Kontabilist, Shoqëri ndërtimi, Agjenci Udhëtimi etj.

Ky aktivitet intensiv është bazuar në një plan vjetor në të cilin janë identifikuar aspektet kryesore duke

vënë në mënyrë të veçantë theksin tek zbatimi efektiv i sanksioneve ndërkombëtare për personat e shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, adresimin e rekomandimeve të Komiteti Moneyval të KiE dhe institucioneve të tjera monitoruese vlerësimin individual të riskut nga subjektet dhe kategorizimin e klientëve të tyre mbi bazën e këtij vlerësimi, zbatimin efektiv të vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar ndaj klientëve, ndryshimet në legjislacionin PP/FT, analizimi dhe raportimi i transaksioneve komplekse tipologjitë dhe treguesit etj.

Tabela 7: Numri i personave të trajnuar në subjekte për periudhën 2016 – 2020.

Subjekti	Nr. i personave të trajnuar				
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Banka	108	364	203	208	57
ZKV dhe agjentë të transferimit të parave	77	35	73	273	492
Institucione jo-bankë	188	115	126	7	146
Shoqëri ndërmjetësimi	-	-	3	-	-
Lojëra Fati	6	3	1	-	-
Noterë/avokat	127	30	221	72	1,167
Auditues Ligjor	1	3	2	114	154
Shoqëri Sigurimi jete, broker	1	1	2	35	66
Autoritete Mbikëqyrëse dhe Institucione	108	27	24	20	354
Shoqëri tregtimi të automjeteve	3	3	-	10	19
OJF	-	-	-	48	-
Shoqëri ndërtimi	8	14	18	13	453
Shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të fondeve të pensionit	1	1	-	8	40
Agjentë të pasurive të paluajtshme	-	-	29	-	41
Agjenci udhëtimi	-	-	-	-	14
SHKK	-	-	-	-	16
<b>Totali</b>	<b>628</b>	<b>596</b>	<b>702</b>	<b>808</b>	<b>3,016</b>



Krahas organizimit të seancave individuale të trajnimit, DPPP ka vijuar bashkëpunimin dhe me autoritete mbikëqyrëse dhe licencuese, me qëllim që të prezantohet sa më mirë përvoja parandaluese e institucioneve si dhe të vlerësohet niveli i përputhshmërisë së subjekteve me legjislacionin PP/FT.

Nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit, është synuar që efekti i tyre të ketë një shtrirje sa më të gjerë të subjekteve, veçanërisht në ato që kategorizohen me risk të mesëm dhe të lartë dhe numri total i personave të trajnuar është 3,016.

Në tabelën vijuese, paraqiten të dhënat periodike, në lidhje me numrin e personave të trajnuar sipas subjekteve të ligjit.

Gjatë vitit 2020 nga ana e DPPP janë organizuar në mënyrë periodike 25 seanca trajnimi, të cilat në kushtet e pandemisë është synuar që të jenë në grupe të kufizuara, për të zbatuar dhe detyrimet e distancimit fizik.

Në bashkëpunim me autoritet mbikëqyrëse janë trajnimet e mëposhtme:

- AMF me pjesëmarrjen e 50 personave me temë “Zbatimin e sanksionet financiare lidhur me terrorizmin”;
- BSH me pjesëmarrjen e 69 personave mbi PPP/FT me pjesëmarrës të IFJB dhe ZKV me temë “Masat kundër Financimit të Terrorizmit (TF) dhe zbatimi i Sanksioneve ndërkombëtare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara”;
- Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar me pjesëmarrjen e 270 personave me temë “Sistemi i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe roli i subjekteve të ligjit.”;

Një rol të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve parandaluese, luan gjithashtu dhe inspektimi në vend apo në distancë i subjekteve nga ana e DPPP, i cili krahas kontrollit për zbatimin e detyrimeve ligjore, ofron dhe ndihmesë në drejtim të zbatimit të ligjit në vijimësi, duke e konkretizuar atë dhe me rastet praktike të punës së tyre.

## Analizimi i përputhshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë

Përputhshmëria e subjekteve raportuese me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e PP/FT, përbën një ndër objektivat kryesorë të veprimtarisë së DPPPP.

Për të siguruar një nivel në rritje të efektivitetit procesit të mbikëqyrjes së përputhshmërisë, puna e drejtorisë është përqendruar në ato kategori subjektesh, të cilat paraqesin një nivel të mesëm apo të lartë të riskut PP/FT.

DPPPP gjatë vitit 2020 edhe pse në kushtet dhe rrethanat anormale të krijuara nga situata e pandemisë, ka mbajtur në vëmendje të vazhdueshme rritjen e efijencës së punës, në sajë

të përdorimit efektiv të burimeve njerëzore dhe logjistike me qëllim që të sigurojë një ndikim sa më të gjerë në nivelin e përputhshmërisë së subjekteve.

Koordinimi dhe bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, ka qenë një nga shtyllat kryesore dhe për këtë qëllim janë realizuar një sërë inspektimesh të përbashkëta në subjektet financiare në bashkëpunim me BSH, në shoqëritë e sigurimit të jetës dhe depozitarëve në bashkëpunim me AMF dhe me BMP për subjektet Ekspertë kontabël.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për inspektimet në vend dhe në distancë të vitit 2020, të krahasuara me periudhat pararendëse.

Tabela 8: Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2017-2020.

Subjektet e Inspektuara	Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020	
	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë
Banka	5	2	7	7	5	-	2	-
Institucione jo-bankë	5	-	7	-	3	9	2	5
Shoqëri ndërmjetësimi	1	-	3	-	-	-	-	-
ZKV	18	27	19	20	16	25	4	38
Ekspertë kontabël	3	9	2	11	10	3	2	8
Shoqëri ndërtimi	14	19	9	14	13	27	11	16
Mjete motorike	-	5	-	-	-	5	1	1
Noterë	6	17	10	39	11	20	9	38
Lojëra Fati	3	3	1	-	-	-	-	-
Sigurim jete dhe ri-sigurim	1	-	2	-	-	-	2	-
Studio Ligjore	-	15	3	-	-	4	5	16
Shoqëri të kursim kreditit	1	-	-	-	-	5	-	3
Metale të çmuara	1	-	-	-	-	-	-	-
Agjenci të pasurive të paluajtshme	3	5	-	19	1	8	-	-
Fonde Investimi/Pensioni/Depozitarë	1	-	1	-	3	-	2	-
Agjenci Udhëtimi	1	6	-	8	-	8	-	1
Shërbime postare që kryejnë shërbime pagesash	-	-	-	-	-	-	1	-
Shuma	63	108	64	118	62	114	41	126
<b>TOTALI</b>		<b>171</b>		<b>182</b>		<b>176</b>		<b>167</b>



Numri total i inspektimeve në vend për vitin 2020 është më i ulët se vitet e kaluara, ndërsa numri i inspektimeve në distancë ka pësuar rritje. Rënia e numrit të inspektimeve në vend, vjen si pasojë e situatës së krijuar dhe masave kufizuese kundër pandemisë.

Gjatë kësaj periudhe i është kushtuar vëmendje e veçantë bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse, dhe informimi i tyre në rrugë shkresore mbi veprimtarinë e DPPPP, rekomandimet e FATF dhe efektivitetin e mbikëqyrjes së subjekteve mbi bazën e riskut. DPPPP ka vijuar t'i kushtojë vëmendje të veçantë inspektimeve të përbashkëta<sup>2</sup> me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, të cilat në vitin 2020 përbëjnë 36% të totalit të inspektimeve në vend.

Bashkëpunimi me këto autoritete, ka një rol në rritje në drejtim të përdorimit efektiv të burimeve njerëzore të DPPPP, shkëmbimit të eksperiencës institucionale, harmonizimit të programeve të mbikëqyrjes dhe orientimit të punës sipas nivelit të kategorizimit të riskut të subjekteve të ligjit.

Gjatë këtij viti, DPPPP është përqendruar në inspektimet në subjektet me risk të lartë<sup>3</sup> të cilat në total janë 116 (71% të totalit të inspektimeve), ndërkohë që në pjesën e mbetur përfshihen subjekte me risk të mesëm dhe të ulët.

Nga inspektimet e realizuara në 2020, janë

konstatuar mangësitë e mëposhtme për të cilat janë propozuar dhe masa administrative.

- Mos raportimi i transaksioneve të kryera në para fizike mbi pragun e përcaktuar në ligj, megjithëse rastet janë sporadike dhe në ulje;
- nuk është kryer monitorim i duhur marrëdhënies së biznesit me klientin;
- nuk është mbajtur një sistem i përshtatshëm i centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave;
- mos kryerja e analizave të thelluara për transaksionet komplekse, në vlera të larta, të pazakonta dhe të pa justifikuara nga pikëpamja ekonomike;
- mangësi në organizimin e trajnimeve të punonjësve dhe në përditësimin e rregulloreve apo procedurave të brendshme me ndryshimet ligjore;
- mos regjistrimi në modulën e raportimit duke sjellë pamundësinë për tu njohur me listat e PEP dhe personave të shpallur si financues të terrorizmit.

Për këto mangësi, DPPPP ka vijuar procesin e shqyrtimit të shkeljeve të evidentuara, ka bërë rekomandimet përkatëse për subjektet dhe njëkohësisht ka vënë në dijeni autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese.

<sup>2</sup> Nga 40 inspektime në vend, 15 prej tyre janë realizuar me BSH (4) me AMF (4), Dhoma Kombëtare e Avokatisë (5) dhe me BMP (2).

<sup>3</sup> Kategorisë dhe numri i inspektimeve respektive (Banka 2, ZKV 40, shoqëri ndërtimi 27 dhe noter 47).

# MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESET GJYQËSORE

## Masat administrative

Gjatë vitit 2020 janë evidentuar subjekte që nuk përmbushin nivelin e duhur të përputhshmërisë me kuadrin rregullator për PPP/FT, për të cilat ka vijuar procesi i shqyrtimit të kundërvajtjes administrative deri në dhënien e vendimit të dënimit me gjobë sipas dispozitave përkatëse. Përveç inspektimeve në vend, janë vlerësuar dhe praktika të mbikëqyrjes në distancë nëpërmjet Raporteve të Vetëkontrollit apo indicie nga monitorimi në distancë i subjekteve për shkelje të detyrimeve ligjore, të cilat zënë edhe peshën kryesore krahasuar me inspektimet në vend.

Minimumi i gjobës së aplikuar ka qenë 100,000 Lek dhe maksimumi 2,000,000 Lek. Vlera totale e

gjobave të vendosura është 7,400,000 Lek.

Peshën kryesore nga subjektet e gjobitura e zënë ZKV me 4 masa administrative në vlerën 2.5 milion Lek, shoqëritë e ndërtimit ndaj të cilave janë aplikuar 3 masa administrative me vlerë 2.2 milion Lek, noterët ndaj të cilave janë aplikuar 6 masa administrative me vlerë totale 1.1 milion Lek.

Masat administrative të vendosura në raport me inspektimet e kryera kanë pësuar ulje, element ky përgjithësisht tregues i rritjes së masave të sistemit parandalues në vend, ndërgjegjësimit si dhe efikasitetit të reagimit ndaj sfidave të përbashkëta.





Nga shqyrtimi i praktikave të inspektimit dhe mbikëqyrja në distancë është konkluduar dhe janë vendosur 15 masa administrative. Kundërvajtjet administrative për subjektet e ligjit konsistojnë në shkelje të kategorizuara në grupime si më poshtë:

- Mos raportim të transaksioneve mbi pragun (pika 3 e nenit 12 të ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008

“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar;

- Moszbatim të detyrimit për kryerjen e vigjilencës së duhur dhe/ose të zgjeruar, sipas neneve 4, 4/1 dhe 5 të ligjit;
- Moszbatim të detyrimit për kryerjen e vigjilencës së zgjeruar, sipas nenit 8/7 të ligjit.



Tabela 9: Numri dhe vlera e masave administrative (në Lek) sipas llojit të subjekteve për periudhën 2016 – 2020

Subjekte	2016		2017		2018		2019		2020	
	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera
Banka	5	10,700,000	5	17,000,000	0	0	0	0	0	0
ZKV	5	3,500,000	8	3,600,000	3	1,100,000	1	500,000	4	2,500,000
Noterë	11	3,400,000	2	1,000,000	4	2,800,000	2	1,100,000	6	1,100,000
IFJB	2	1,000,000	1	500,000	0	0	1	500,000	1	600,000
Lojëra Fati	4	3,600,000	1	500,000	0	0	0	0	0	0
Shoqëri Ndërtimi	4	3,800,000	9	6,000,000	10	9,800,000	5	3,000,000	3	2,200,000
Agjenci udhëtimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shoqëri Sigurim Jete	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shoq. tregtimit të mjeteve motorike	2	4,000,000	0	0	1	500,000	1	600,000	1	1,000,000
<b>TOTALI</b>	<b>33</b>	<b>30,100,000</b>	<b>26</b>	<b>28,600,000</b>	<b>18</b>	<b>14,200,000</b>	<b>10</b>	<b>5,700,000</b>	<b>15</b>	<b>7,400,000</b>

## Ekzekutimi i masave administrative dhe proceset gjyqësore

Gjatë vitit 2020 janë arkëtuar në total 6,313,000 Lek nga të cilat 1,989,000 Lek janë arkëtime nga masat administrative të vendosura në vitet e mëparshme, ndërsa 4.324.000 Lek lidhen me masa të vendosura këtë vit.

Tabela 10: Të dhëna për arkëtimet për periudhën 2016 – 2020

Zërat	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Vendime për Gjopa	33	26	18	10	15
Shuma totale e gjobave LEK	30,100,000	28,600,000	14,200,000	5,700,000	7,400,000
Shuma totale e arkëtimit LEK	31,786,000	27,788,000	22,590,643	5,018,000	6,313,000

Nga masat administrative të vendosura gjatë këtij viti, 8 (tetë) prej tyre janë arkëtuar, kurse pjesa tjetër janë në proces.

Për të rritur efikasitetin e ekzekutimit të masave administrative, DPPP ka ndjekur me vëmendje fazat e ekzekutimit me zyrat përmbarimore, duke rritur në këtë mënyrë edhe efikasitetin e kësaj veprimtarie, deri në përbushjen e fazave të ekzekutimit të detyrueshëm.

DPPP i ka kushtuar vëmendje të veçantë ndjekjes së proceseve gjyqësore në lidhje me masat administrative të vendosura, nga ku çështje gjyqësore të përfunduara gjatë këtij viti me vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë janë 5 çështje, si vijon:

- për dy procese vendimet janë dhënë në favor të DPPP;
- për dy procese vendimet janë dhënë, në favor të subjekteve;
- për një çështje është marrë nga gjykata vendim pushimi.

Janë shpallur vendime në Gjykatën Administrative të Apelit për dy çështje për të cilat një vendim është dhënë në favor të subjektit dhe për një çështje tjetër është vendosur rrëzimi i kërkesës në favor të DPPP.

# BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

## Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave

Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, si organi më i lartë përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, organizoi mbledhjen e radhës në datë 16.12.2020, në një takim online, diktuar nga kushtet e krijuara nga pandemia globale Covid-19.

Me ndryshimet ligjore të vitit 2019, Komiteti zgjeroi anëtarësinë me pjesëmarrjen edhe të Drejtuesit të Prokurorisë të Posaçme (SPAK), Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë të Shtetit dhe Drejtorin Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Komiteti në mbledhjen e zhvilluar i kushtoi një vëmendje të veçantë ecurisë dhe përmbushjes të rekomandimeve të Komitetit Moneyval si dhe planit të veprimit të ICRG/FATF. Gjithashtu gjatë kësaj mbledhjeje, Komiteti miratoi rishikimin e planit të veprimit për zbutjen e risqeve të identifikuara në vlerësimin kombëtar të riskut për pastrim parash dhe financim terrorizmi dhe analizave të riskut të hartuara për këtë qëllim.

## Bashkëpunimi kombëtar ndër-institucional

Përkushtim dhe angazhim maksimal është treguar përsa i përket koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional me institucione të tjera brenda vendit, jo vetëm në rolin e DPPPP si koordinatore e procesit të vlerësimit nga Moneyval dhe FATF, por edhe në kuadër të bashkëpunimit për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.


Edhe pse në periudhë pandemie, DPPPP ka pasur një korrespondencë të vazhdueshme dhe intensive me DPPSH dhe Prokuroritë e vendit, për shkëmbim informacioni dhe reagimin në kohë dhe efektiv për rastet nën hetim apo procedim, veçanërisht për rastet e referuara nga DPPPP.





Gjatë vitit 2020, janë trajtuar 371 kërkesa për informacion të ardhura nga DPPSH me të cilat është kërkuar informacion për 2,506 persona. Nga prokurori të ndryshme janë dërguar 309 kërkesa për informacion, me të cilat janë kërkuar të dhëna për 2,451 persona për të cilët DPPPP ka kryer verifikime dhe ka informuar në kohë këto institucione.


Grafiku 2: Numri i kërkesave për verifikime dhe numri i personave të përfshirë



DPPPP, gjatë vitit 2020 ka vijuar bashkëpunim intensiv me OFL (Operacioni Forca e Ligjit) duke kthyer përgjigje me prioritet për 990 kërkesa të ardhura, me të cilat është kërkuar informacion për 5,302 persona.

Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e punës së DPPPP vijon të jetë shkëmbimi i informacionit me institucionet e tjera si: KJV, KPK, BSH, DSIK, AMF etj., në kuadër të kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave të tyre, edhe pse në kushtet e vështira të pandemisë dhe me personel të reduktuar, DPPPP është impenjuar maksimalisht për të respektuar afatet ligjore të kthimit të përgjigjeve për këto institucione.

Grafiku 3: Numri i kërkesave për verifikime dhe numri i personave të përfshirë



## Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë vitit 2020 kemi shkëmbyer rregullisht informacion me NjIF partnere nëpërmjet rrjetit EGMONT.

Për shkak të pandemisë, në vitin 2020 nuk u zhvillua mbledhje plenare e këtij grupi.

## Procesi i vlerësimit nga komiteti Moneyval i KiE

Gjatë vitit 2020, vendi ynë ka qenë në proces monitorimi të përforcuar nga Komitetit Moneyval, si dhe njëkohësisht në një periudhë monitorimi nga ICRG (Grup i posaçëm pune i FATF). Dy proceset e vlerësimit/monitorimit, ai i Moneyval dhe ICRG, janë të ndërthurur me njëri tjetrin, por edhe të pavarur mes tyre.

Shqipëria gjatë vitit 2020, për strukturën e Moneyval, dërgoi në muajin Nëntor raportin e radhës, vlerësimi i të cilit pritet të miratohet gjatë vitit 2021 në plenaren e 61 të Komitetit Moneyval. Në këtë raport pritet të konfirmohet rritje e vlerësimit për Rekomandimin 7 të FATF (zbatimi i sanksioneve financiare për personat e shpallur, në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurisë), në funksion të të cilit Shqipëria miratoi ligjin 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në RSh”.


Për pjesën e efektivitetit të sistemit shqiptar të parandalimit të PP/FT, raportimi vijon të kryhet në grupin e punës së ICRG/FATF.



## Shkëmbimi i informacioneve me NjIF

Gjatë vitit 2020 kemi shkëmbyer informacion me NjIF partnere, të detajuara si më poshtë:

Grafiku 4: Shkëmbimi i informacionit me NjIF





## Procesi i vlerësimit nga ICRG

Shqipëria vijon të jetë në proces monitorimi nga ICRG, për pjesën e efektivitetit të sistemit shqiptar të parandalimit të pastrimit të parave. Shqipëria ka përgatitur dhe dërguar dy raporte për vlerësim në ICRG, përkatësisht në muajt Gusht dhe Dhjetor 2020.

Gjatë vitit 2020, Shqipëria u vlerësua pozitivisht për hapat e ndërmarra për zbatimin e planit të veprimit, pavarësisht nga vështirësitë e krijuara nga pandemia e COVID-19. Ekspertët e ICRG vlerësuan Shqipërinë për hartimin dhe miratimin në një kohë shumë të shpejtë të disa ligjeve të rëndësishme që ndihmojnë në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të tilla si ligji “Për regjistrimin e pronarëve përfitues” dhe ligji “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”. Për më tepër, Shqipëria u vlerësua edhe për hartimin e projektligjeve të shumta si ai rregullimit të sektorit të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e organizatave jofitimprurës apo dhe ndryshimet në ligjin për noterinë. Këto projektligje pritet të miratohen nga parlamenti gjatë vitit 2021.

Gjithashtu Ekspertët e ICRG vlerësuan faktin që Shqipëria tashmë ka përfunduar një sërë vlerësime risku në sektorë specifikë si avokatët, noterët, ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme dhe produktet bankare, si dhe ka forcuar koordinimin dhe bashkëpunimin institucional për zbatimin e masave të nevojshme që rrjedhin nga Vlerësimi Kombëtar i Riskut të PP/FT.

## Ndryshime ligjore



DPPPP gjatë vitit 2020 ka hartuar dhe përmirësuar disa akte të rëndësishme nënligjore, në funksion të zbatimit të ligjit 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (i ndryshuar), të cilat paraqiten në vijim:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 458, datë 10.6.2020 “Për përcaktimin e faktorëve dhe të situatave që merren parasysh në vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Ky vendim është miratuar me synim vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, që lidhen me llojin e faktorëve, klientëve, të zonës gjeografike, të produkteve, të shërbimeve, të transaksioneve apo të kanaleve të veçanta të shpërndarjes, në rastet e zbatimit të vigjilencës së thjeshtuar.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 457, datë 10.6.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”.
- Ky vendim parashikon mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 29, datë 28.7.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 28, datë 31.12.2012, të Ministrit të Financave “Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”.
- Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 28.7.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 29,

datë 31.12.2012, të Ministrit të Financave “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jo financiare”.

Në këto dy udhëzime janë miratuar gjatë vitit 2020, ndryshime ligjore që synojnë harmonizimin me kuadrin e ri ligjor të prezantuar me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar. Ndryshimet lidhen kryesisht me identifikimin e klientit, masat e ndërmarra në kuadër të vigjilencës së zgjeruar, udhëzime për tu ndjekur nga shoqëritë e transfertave dhe parave dhe vlerave, si dhe përmirësimi i formularëve të detyrueshëm për raportim nga subjektet e ligjit.

DPPPP nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet përkatëse të punës kontribuoi gjatë vitit 2020 edhe në hartimin e akteve ligjore të mëposhtme:

- Ligji nr. 112/2020 datë 29.7.2020 “Për regjistrin e pronarëve përfutues”.
- Ligji nr. 154/2020, datë 17.6.2019 “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”.

Të dy ligjet u hartuan me synim përafrimin e plotë me Direktivën (BE) 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 20 maj 2015 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” e ndryshuar nga Direktiva (BE) 2018/843.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.454, datë 10.6.2020 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim ka dalë në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në RSh” në përmbushje të Rekomandimit 7 të FATF.

# BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TI

## Buxheti dhe menaxhimi i tij

Gjatë vitit 2020, DPPP ka shpenzuar në total rreth 64 milionë lekë, ose 21.5 % më pak krahasuar me vitin 2019. Realizimi i shpenzimeve rezultoi në masën 99 % të fondit të buxhetuar.


Shpenzimet ishin të ndara në 62.5 milionë lekë shpenzime korrente dhe 2 milionë lekë shpenzime kapitale. Raporti i shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale, ndaj totalit rezultoi respektivisht 96,9 % dhe 3,1 %. Krahasuar me vitin 2019, kur struktura e shpenzimeve ishte 68 % korrente dhe 32 % kapitale, vërehet ulje e ndjeshme e peshës relative të shpenzimeve

kapitale ndaj totalit, si pasojë e uljes së fondit të buxhetuar për investime.

Shpenzimet korrente kanë qenë në të njëjtat nivele krahasuar me një vit më parë dhe janë realizuar në masën 100% të planit.

Shpenzimet kapitale të buxhetuara, kanë qenë më të ulëta krahasuar me vitin 2019 dhe 2018. Realizimi i tyre, kundrejt planit final për 2020 ishte 84%. Mosrealizimi është për pjesën e shpenzimeve kapitale të planifikuara për pajisje për zyrat shtesë që ishte parashikuar t'i jepeshin DPPP.


Grafiku 5: Fondet buxhetore të akorduara dhe përdorimi i tyre në vite.








Grafiku 6: Shpenzime korrente në dispozicion dhe përdorimi i tyre në vite.



Grafiku 7: Shpenzime kapitale (investime) në dispozicion dhe përdorimi i tyre në vite.



DPPPP do vijojë të jetë e angazhuar në administrimin efektiv të buxhetit, transparencën dhe përmirësimin e procesit të planifikimit, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike të akorduara, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës së TI, duke mundësuar zbatimin dhe arritjen e objektivave institucionale, në luftën kundër PP/FT.

## Menaxhimi i burimeve njerëzore

Gjatë 2020, struktura organizative e DPPP me një numër total strukturor prej 45 punonjësish ka pasur një realizim mesatar prej 89 %. Për këtë periudhë, në bashkëpunim me strukturat e Departamentit të Administratës Publike, janë realizuar procedurat e rekrutimit për plotësimin e nëntë pozicioneve vakante në institucion, të krijuara nga largimet me dëshirë gjatë vitit, në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij. Nga këto pozicione vakante, tetë kanë qenë rekrutime në nivel ekzekutiv dhe një pozicion në nivel drejtues.

Nëpërmjet strukturës përgjegjëse, janë mbikëqyrur dhe administruar burimet njerëzore, në zbatim të parimeve dhe kriterëve të legjislacioni në këtë fushë, si dhe janë kryer proceset e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve, në përputhje me afatet ligjore.

DPPP ka mundësuar rritjen profesionale të stafit dhe përfitimit të njohurive të reja në fushën e parandalimit të PP/FT, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të organizuara kryesisht në distancë nëpërmjet internetit, për arsye të kushteve të diktuara nga pandemia.

Gjatë 2020, 17 punonjës të DPPP kanë qenë pjesëmarrës në 28 trajnime kryesisht në distancë. Temat kryesore që janë trajtuar në këto trajnime kanë qenë:

- Plani i implementimit të mbikëqyrjes së bazuar në risk;
- Teknikat e hetimit financiar;




- Gjurmimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i Aseteve;
- Udhëzime dhe indikator për parandalimin e krimit kibernetik;
- Metodot dhe teknikat analitike për investigimin e PP/FT;
- Trafikimi i qenieve njerëzore;

DPPP, në kuadër edhe të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë për arritjen e objektivave në luftën kundër PP/FT, do të vazhdojë të ndjekë politika prioritare për përmirësimin e kapaciteteve profesionale, të bazuara jo vetëm në rritjen në numër të strukturës organizative por dhe në rritjen profesionale të personelit nëpërmjet ofrimit të mundësive dhe përfshirjes në trajnime.



Organigrama e DPPPP:





## Teknologjia e informacionit

Gjatë vitit 2020 ka vijuar konsolidimi i infrastrukturës së TI dhe është përgatitur dokumentacioni për rikreditimin e rrjetit informatik të DPPPP në zbatim të detyrimeve të VKM Nr.542, datë 25.7.2019, "Për miratimin e rregullores "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI).

Sigurimi i mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së informacionit është realizuar në vijimësi në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë të specialistëve të TI në DPPPP, me kolegët e tyre të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, DPPSH, DSIK, DPD, DPT, Dhomën Kombëtare të Noterisë, ASHK, BSH, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe sektorit privat. Në sajë të këtij bashkëpunimi të vazhdueshëm, DPPPP ka arritur të siguroj një qasje normale në bazat e të dhënave të këtyre institucioneve për të mundësuar një analizë të gjithanshme dhe cilësore të informacionit, për

çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Të dhënat që raportohen nga subjektet e ligjit, zënë peshën kryesore të informacionit që mbledh dhe përpunon DPPPP dhe për këtë qëllim është punuar pa reshtur, për të realizuar funksionimin normal të moduleve të raportimit, duke ofruar një mbështetje të vazhdueshme teknike për këto subjekte si dhe për përdoruesit e një sërë institucioneve shtetërore.

Shkëmbimi i sigurt i informacionit me NjIF partnere ka pësuar ndryshime cilësore, duke përmirësuar aplikacionet dhe standardet ekzistuese të sigurisë. Kjo ka diktuar nevojën e mbarëvajtjes dhe testimit permanent të funksionimit të mekanizmave të rinj, duke realizuar një mbikëqyrje të vazhdueshme, në përputhje me standardet dhe politikat e sigurisë të grupit Egmont.

# OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021

Përpjekjet dhe puna e bërë gjatë vitit 2020, do të shërbejë si pikënisje për çuarjen më tej të objektivave të vendosura në luftën dhe parandalimin e PP/FT. DPPPP mbetet e angazhuar për përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor, rregulloreve dhe procedurave si dhe proceseve të punës.

Përveç objektivave ligjor të DPPPP që janë pjesë e detyrave funksionale të institucionit, gjatë vitit 2021 vëmendje të posaçme do të ketë:

- Raportimi në ICRG/ FATF, Moneyval dhe ndjekja e planit të veprimit;
- Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së TI;
- Konsolidimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes së subjekteve të ligjit mbi bazën e riskut të PP/FT dhe bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese;
- Trajnimi i vazhdueshëm cilësor i subjekteve të ligjit dhe punonjësve të DPPPP.
- Ndjekja e planit të veprimit për adresimin e mangësive të evidentuara nga vlerësimi kombëtar i riskut si dhe analizat e tjera sektoriale;
- Realizimi i ndryshimeve ligjore për afrimin e mëtejshëm të legjislacionit vendas me *acquis communautaire* në fushën e parandalimit të PP/FT.



**ADRESA:**

Ministria e Financave  
dhe Ekonomisë  
Blv. "Dëshmorët e  
Kombit", Nr.3, Tiranë



**KONTAKTE:**

Tel: +355 42 24 4 602  
Mail: [info@fint.gov.al](mailto:info@fint.gov.al)  
web: [www.fiu.gov.al](http://www.fiu.gov.al)